
	<p><b>Republika e Kosovës</b> <span style="float: right;">01-1176</span>          Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b>          Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-391/02-88028/24 dt.08.07.2023, të kërkesve/pronarëve, Nusret Miftari nga Prishtina dhe investitorit, “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me pronar Avni Kastrati nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, përkatësisht 4 (katër) shtëpi të Tipit “A”, të ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimore Komunal në Prishtinë, në rr. “Andrea Durrsaku” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 15.10.2024, lëshon këtë:

## C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

**I. I LEJOHET** kërkesve / pronarit Nusret Miftari nga Prishtina dhe investitorit, “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me pronar Avni Kastrati nga Prishtina, sipas kërkesës 05-391/02-88028/24 dt.08.07.2024, përdorimi i 4 (katër), ndërtesave/shtëpi individuale të banimit, Tipi “A” (tri shtëpi) me etazhitet P+1 dhe Tipi “A” (një shtëpi) me etazhitet B+P+1, dhe të ndërtuar sipas “*Vendimit për Lejimin e Ndërtimit*”, 05 Nr.351/02-26852/20 dt.03.07.2020, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelat kadastrale nr. 1297-3, 1297-4, 1297-5, dhe 1297-6, ZK. Çagllavicë, në kuadër të Planit Zhvillimore Komunal në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Andrea Durrsaku” ku janë dalje hyrjet e këtij kompleksi të shtëpive me numrat: 16, 18, 20, dhe 22, në Prishtinë, dhe e njëjtat do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkesit / pronarit, Nusret Miftari nga Prishtina dhe investitorit, “Ada Consulting Group” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Nora e Hotit”, Bll. C2-10 Obj. B H1-4/2, me certifikate të biznesit ARBK 810794215, me pronar Avni Kastrati nga Prishtina, me kërkesën 05-391/02-88028/24 dt.08.07.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për 4 (katër), ndërtesa/shtëpi individuale të banimit, Tipi “A” (tri shtëpi) me etazhitet P+1 dhe Tipi “A” (një shtëpi) me etazhitet B+P+1, të ndërtuara në kuadër të Planit Zhvillimore Komunal në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1297-3, 1297-4, 1297-5, dhe 1297-6, ZK. Çagllavicë, ndërtuar sipas “*Vendimit*

për Lejimin e Ndërtimit”, 05 Nr.351/02-0247279/17 dt.06.05.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-235106/23 dt. 31.01.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenar Veseli; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Skender Loshi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Gresë Qorri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agim Kastrati; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Arton Hetemi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike dhe instalimet e makineris konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat/shtëpi individuale të banimit, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat/shtëpi individuale të banimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 391/02-88028/24 DT. 15.10.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  